

“PËRVEÇ AGJËRIMIT, AI ËSHTË I IMI...”



رَضْوَانُ اللَّهِ عَلَيْهِ

*“Kur hyn muaji i Ramazanit,
hapen dyert e xhennetit,
mbyllen dyert e xhehneimit
dhe lidhen shejtanët
me zinxhirë”, - thoshte
i dërguari i All-llahut,
Hz . Muhammedi (a.s),
si për të na sinjalizuar
mundësitë e mëdha që i jepen
njeriut në këtë muaj,
për të gjetur vetëveten,
për të konsoliduar besimin,
për ta dëshmuar
mirësinë e tij në jetë.*



SHTZ. Bujar Nishani
President i Shqipërisë

Të dashur besimtarë myslimanë, praktikantë ose jo, si dhe të gjithë Ju që besimin mysliman e respektoni:

Nesër është një ditë e veçantë.

Nesër nis muaji i sakrificës dhe reflektimit, muaji i Ramazanit.

Ju uroj nga zemra dhe me gjithë shpirt këtë rit me rëndësi të pallogaritshme, këtë Festë, e cila prej shekujsh lartëson shpirtat dhe kthjellon mendjet e miliona besimtarëve në mbarë botën, këtë mrekulli sa qiellore dhe tokësore,

MESAZHI I PRESIDENTIT TË SHQIPËRISË, ME RASTIN E MUAJIT TË RAMAZANIT

Ramazani na jep rastin të shtojmë vetëkontrollin, të frenojmë emocionet, të shohim çfarë nuk shkon në jetët tona, ku i kemi defektet, të shtojmë syçelësinë ndaj shembujve të këqij që t'i ndreqim...

sa të bukur dhe të dobishme!

Ramazani është Festa që realizon lidhjen mes sakrificës së vullnetshme hyjnore me efektet pozitive tokësore të asaj sakrifice.

Duke i bërë besimtarët, dhe jo vetëm ata, që të harrojnë dasitë e përditshmërisë, Ramazani mundëson gjithçka që lypset për një jetë normale, dinjitoze; afron njerëzit, rrit vetëdijen mbi detyrat dhe të drejtat, sjell në vëmendje vlerat njerëzore, afron të mirat, ndjeshmërinë, mëshirën, dhembshurinë, dashurinë, largon të këqijat, veset, hilet, zënkat, sherret, por më së shumti afron secilin njeri veç e veç dhe të gjithë njerëzit bashkë me Zotin.

Janë të panumërta dhe të

pakrahasueshme të mirat që sjell Ramazani.

Duke na bërë më të ndjeshëm dhe më të dashur, Ramazani na jep rastin të shtojmë vetëkontrollin, të frenojmë emocionet, të shohim çfarë nuk shkon në jetët tona, ku i kemi defektet, të shtojmë syçelësinë ndaj shembujve të këqij që t'i ndreqim, si dhe të shohim ku i kemi shembujt e mirë e të dobishëm që t'i inkurajojmë që të shpeshtohen.

Ramazani e bën pra njeriun më të mirë, më të butë, më të kujdesshëm, më të vëmendshëm ndaj vetes dhe gjithë të tjerëve.

Ju uroj Ramazan të lehtë, mendje të kthjellët, shpirt të kulluar!

**“Në xhenet është një derë, e cila quhet “Rejjan”,
përmes saj hyjnë agjëruesit në Ditën e Kiametit.**

Askush tjetër nuk hyn prej saj, përveç tyre.

Thuhet: Ku janë agjëruesit?

**Ata ngrihen në këmbë, hyjnë nga ajo derë,
pastaj ajo mbyllet”.**

(Buharin)



MESAZHI I MYFTIUT TË SHKODRËS, IMAM MUHAMED SYTARI ME RASTIN E RAMAZANIT 1436/2015

*Të dashur vëllezër dhe motra muslimanë,
Të nderuar bashkëqytetarë të mi,*

Sonte, krejt ne presim me padurim momentin e shfaqjes së Hanës së re të Muajit Ramazan, që sinjalizon fillimin e begatë të këtij muaji të madh, shenjë mëshire, dashurie dhe begatie, nga Zoti për njeriun, sidomos për besimtarët!

Rikthimi i Hanës së re të Ramazanit, do të thotë edhe një mundësi e re për të rivlerësuar besën e besimit dhe dorëzimit me zemër e mendje para duarve të Krijuesit, që pret me mëshirë dhe falje, të gjithë ata që kthehen nga Dera e madhe e dashurisë së Tij.

Sot, mbarë bota po kalon momente të vështira, të mbushura me pasiguri, dhunë, luftë, shkelje flagrante të drejtave të njeriut, skamje, uri, varfëri, islamofobi, devijime nga e vërteta, rrëshqitje drejt shthurjes morale, intelektuale, laicizëm selektiv etj. pa fund.

Në tërë këtë zyrtësi realitetesh, rikthimi i Hanës së re të Ramazanit, mbetet përherë një shenjë shprese,

një mundësi kthese, një hapësirë lutjeje dhe një alternativë shpëtimi nga hijet e së keqes, që është përhapur kudo.

“Kur hyn muaji i Ramazanit, hapen dyert e xhenetit, mbyllen dyert e xhehemit dhe lidhen shejtanët me zinxhirë”¹, - thoshte i dërguari i Allllahut, Hz. Muhammedi (a.s), si për të na sinjalizuar mundësitë e mëdha që i jepen njeriut në këtë muaj, për të gjetur vetëveten, për të konsoliduar besimin, për ta dëshmuar mirësinë e tij në jetë.

Të dashur besimtarë,

Ramazani njihet ndryshe edhe si muaji i Kur’anit. Kthehuni me zemër nga Fjala e Zotit, merreni në duar dhe lexojeni atë. Shfrytëzoni ditën dhe natën, për ta përvetësuar dritën e Kur’anit dhe për t’ia mëkuar atë edhe fëmijëve tanë, që po rriten në realitete pa dritë besimi, pa udhëzim hyjnor, plot thirrje tinzare, që i largojnë

1. Ahmed i në “El-Musned”, Bukhariu dhe Muslimi, nga Ebu Hurejra (r.a).

nga e vërteta dhe bukuritë e saj!

Ju e shihni dita-ditës se të tjerët nuk ngurrejnë të dëshmojnë shthurjen dhe devijimin, haptas, pa ndrojtje, pa frikë, madje edhe të mbrojtur nga dikush, që ka devijuar njësoj si ata, në mos më keq!

Ramazani vjen për t’ju forcuar në ndërgjegjen e besimit tuaj, ai ju fton ta dëshmoni këtë mirësi, të mos hezitoni, të mos keni frikë, të mos ngurrioni, të mos ndaleni së ftuari drejt Dritës së Zotit, të mos frenoni zemrën së përqaftuari me bekimet e ditëve dhe netëve të këtij muaj mrekullibërës!

Prandaj, më lejoni t’ju përhapoj me zemër në prag të Hanës së re të këtij Muaji të shumëpritur, t’ju uroj agjërim të mbarë dhe lutje të pranuar, ju, familjeve tuaja, Shkodrës tonë, Shqipërisë së shtrenjtë, krejt trevave shqiptare, mbarë ymnetit islam!

Mubarek Ramazanin!

Shkodër, 17 qershor 2015





Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë vetëm All-llahut, Zotit të Vetëm të botëve. Atij, që e bëri agjërimin e Ramazanit, rrugë të sigurt drejt përkushtimit në jetë. Për këtë thotë në Kur'anin Famëlartë: "O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim, sikurse ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, që të bëheni të përkushtuar"¹

Salavatet dhe përshëndetjet më të përzemërta ia dërgojmë sot në këtë ditë dhe në çdo ditë, zotërisë së bijve të Ademit, Hz. Muhammedit (a.s), i cili na mësoi madhështinë e agjëritimit të Ramazanit, me fjalët e tij: [Të gjitha veprat e birit të Ademit shumëfishohen: e mira sa dhjetëfishi i saj deri në shtatëqindfish. All-llahu i Madhëruar thotë: "përveç agjëritimit, ai është i Imi dhe Unë e jap shpërblimin për të! (Besimtari) Lë epshin e tij dhe ushqimin e tij për Mua! Agjëruesi ka dy gëzime: një gëzim në momentin e iftarit dhe një gëzim, në momentin e takimit me Zotin e tij! Era e gojës së agjëruesit, është më e mirë tek All-llahu, sesa era e misku!"²

Të dashur dhe të nderuar vëllezër muslimanë,

Tashmë, pasi përcollëm me adhurime e lutje Natën e Gjysmës së Shabanit, gjithësia nis të përgatitet për të prituri Hënë të fatlume të krejt vitit, Hilalin e Ramazanit, muajin e begatë, që gjallëron jetën dhe qetëson zemrat me nënshtrimin para

1. Kur'ani, El-Bekare: 183. (Me përshtatje nga versioni i H. Sherif Ahmedit).

2. Transmetuar nga Muslimi, nga Ebu Hurejra (r.a).

"AI ËSHTË I IMI DHE UNË SHPËRBLEJ PËR TË!"

duarve të All-llahut, Mëshirëbërësit, Mëshirëplotë.

Tashmë, që ditët e mbërritjes së tij kanë nisur të numërohen me gishtat e duarve, një pyetje duhet të qarkullojë në mendjen e secilit prej nesh: Si po e pres Ramazanin?

E, në këtë përshpirtje, më lejoni të sjell para duarve tuaja një përshkrim të bukur të atmosferës së Ramazanit në krahët e historisë islame, që e lexova para pak ditësh.

Muaji Ramazan, i veshur me metaforën e shekujve dhe viteve të historisë së ymnetit islam, i drejtohet agjëruesve me këto fjalë: "Pritja që më bënin njerëzit ishte shembullore, bujare. Agjëruesit mendonin për mua para se t'ju vija. Përgatiteshin për ardhjen time, shumë kohë më përpara zbritjes time në shtëpitë e tyre, si mik i shtrenjtë. Për shembull: ai që kishte lënë namazin pas dore, merrte gusul, vishej me rroba të pastra dhe më priste me pendim dhe kthim nga Zoti. Ai kishte pirë alkoolin, para ardhjes sime, thyente shishen dhe derdhte gotën, pendohej me zemër para Krijuesit të Tij. Ai që kishte devijuar nga rruga e besimit, me argëtime dhe humbje kohe, me shthurje dhe epshe të pakontrolluara, kthehej me sinqeritet, duke larë fytyrën e tij me lotët e kthesës... Nuk dua të flas për tregtarët e pasanikët, All-llahu i mëshiroftë dhe ua lartësoftë shpirtrat në gradët më të larta të xhennetit! As për ndërtimet e xhamive, medreseve, për ndihmën ndaj vejushave e jetimëve, All-llahu ua shpërbleftë në ahiret me shoqërimin e profetëve dhe të dërguarve..."³

Në fakt, teksa lexojmë për mirësitë pa fund, që ky muaj i madhërisëm

3. Shejkh Ahmed Keftaro, "Min hedjil-Kur'an", përgatitur për botim nga Zahir Ebu Davud, Damask, pa vit botimi, f. 225-226. (Në fund të shkrimit me titull: "Ramadan jetehaddeth (1)", që mban shënimin: "Ligjëratë e mbajtur më 8.3.1961".)

sjell me vete, nuk ka sesi të mos kuptojmë se Ramazani, në të vërtetë, është një muaj që duhet të krijojë ndryshim në jetën tonë. Ndryshim në sjelljen tonë, në komunikimin tonë me njëri-tjetrin, në lidhjet farefisnore, në pamjen e jashtme etj, që sinjalizojnë edhe shoqërinë për madhështinë dhe shenjtërinë e tij!

Teksa flet për shenjat e Ramazanit në jetën e muslimanëve, Hoxha i jonë, H. Vehbi Sulejmani, shkruan: "Shfaqjet e shturrjes dhe degjenerimit fshihen nga jeta

"Shfaqjet e shturrjes dhe degjenerimit fshihen nga jeta e përditshme, njerëzit kthehen nga namazi dhe Kur'ani... Shfaqjet e përkushtimit mbulojnë jetën e përditshme të njerëzve. Gratë kontrollojnë veshjen e tyre, duke u mbuluar, pakësohet zhurma e muzikës shqetësuese dhe dëgjimi i saj. ..."

e përditshme, njerëzit kthehen nga namazi dhe Kur'ani... Shfaqjet e përkushtimit mbulojnë jetën e përditshme të njerëzve. Gratë kontrollojnë veshjen e tyre, duke u mbuluar, pakësohet zhurma e muzikës shqetësuese dhe dëgjimi i saj. Shenjat e vëllazërisë dhe gëzimit shfaqen kudo në fytyrat e njerëzve; të pasur e të varfër. Shtohet afrimi i zemrave dhe paqtimi i tyre. Shtohen vizitat dhe

iftaret në mesin e të afërmeve dhe të dashurve, e veçanërisht për të varfërit, kur dihet sesa vlerë kanë adhurimet dhe bamirësitë në Ramazan... Shtohet mirëbërja, dhënia e sadekave dhe shkaqet e gëzimit në jetën e nevojtarëve... Madje, edhe jomuslimanët nuk shfaqen duke ngrënë në sy të muslimanëve, në nderim të ndjenjave të muslimanëve...”⁴

Prandaj, kur lexojmë rreth historisë së shpirtit të Ramazanit në jetën e të parëve tanë dhe bëjmë krahasime me realitetet tona, kuptojmë sesa përgjegjësi të madhe ka secili prej nesh në rrugën e rimëkëmbjes së vlerave të pritjes së Ramazanit dhe të jetuarit me të në shoqërinë tonë.

Asnjëri prej nesh nuk duhet të neglizhojë atë që ai mund të bëjë, për ta përkthyer sa më mirë agjërimin e Ramazanit në atmosferën e prekshme të këtij muaji, me sjelljen e tij, me edukatën e tij, me përkushtimin në punë, me mirëkuptimin në xhami, me qetësinë e dëshmuar, me harmoninë në familje etj!

Kemi nevojë, që madhështia e këtij muaji, të mos përkufizohet vetëm nëpër xhami, por të përhapet edhe në rrugët tona, në televizionet tona lokale, në dyqanet tona, në shtëpitë tona, në biznese dhe kudo.

Jam ndjerë shumë mirë, kur kam dëgjuar para një viti në një prej radiove dhe televizioneve tona lokale, se fabrika e drurit e njërit prej vëllezërve tanë në Shkodër, reklamonte se: “Me rastin e Muajit Ramazan bën ulje x % nga të gjitha prodhimet e saj”. Këtë nënkuptoj me përkthim të Ramazanit në atmosferën e prekshme të këtij muaji, secili në fushën e vet deh në mundësitë që i janë dhënë!

Vëllezërit e mi,

Duhet të dijmë dhe t’ia përcjellim edhe të tjerëve se “agjërimi është një prej shtyllave më të rëndësishme të fesë dhe ndër ligjet më solide të Islamit tonë, nëpërmjet të cilit mposhtet nefs i urdhërues për keq...

4. Vehbi Sulejman Gavoçi, “Es-Sijamu ve ahkamuhu”, botimi i parë, Bejrut, 1979, f. 20.

*"Shenjat e vëllazërisë
dhe gëzimit shfaqen kudo
në fytyrat e njerëzve;
të pasur e të varfër.
Shtohet afrimi i zemrave
dhe paqtimi i tyre.
Shtohen vizitat dhe iftaret
në mesin e të afërmeve
dhe të dashurve,
e veçanërisht për të varfërit,
kur dihet sesa vlerë
kanë adhurimet
dhe bamirësitë
në Ramazan...
Shtohet mirëbërja,
dhënia e sadekave
dhe shkaqet e gëzimit
në jetën e nevojtarëve..."*

Ai është më i vështiri obligim për nefs... Teksa privohet nga ushqimi, nefs i ndjen dhimbje dhe nis të përjetojë nënshtrimin e adhurimit, derisa qetësohet para duarve të Zotit... Kësisoj, lumturia është, kur njeriu e përmban nefs i tij, ndërsa krejt mjerimi është, kur njeriu mbizotërohet nga nefs i tij!”⁵

Ramazani është muaji i kësaj vlere, i nënshtrimit të nefsit në jetë! [Eba bin Ka’bi për devotshmërinë e kishte pyetur Omer bin Hatabin (r.a), i cili në formë pyetjesh ishte përgjigjur: “A ke udhëtuar nëpër rrugë me ferra?” Ai u përgjigj: “Po.” Ai e pyeti: “Si veproje?” Ai tha: “U ruajta dhe u lodha.” Ai (Omeri) tha: “Kjo është devotshmëria!”]⁶

5. Muhammed Emin (Ibn Abidin), “Redd-ul-muhtar alad-der-ril-mukhtar sherh tenvirul-ebsar”, botimi i dytë, Bejrut, 2003, vëll. i 3-të, f. 327-328.

6. Abdullah Halife, “Mirësia e Ramazanit – Si ta arrish atë?”, e përktheu dhe përshtati nga

Prandaj, le të bëhemi gati me zemër e me shpirt, me trup dhe me emocionet tona, për pritjen e duhur të këtij muaji, që është nisur drejt nesh, si një bekim nga All-llahu i Madhëruar, i Cili thotë në Kur’anin Famëlartë: “Muaji i Ramazanit, në të cilin (filloi të) shpallet Kur’ani, që është udhërrëfyes për njerëzit, sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria)...”⁷

Kësisoj, le të angazhohemi me sa të kemi mundësi, për të nisur përjetimin e pritjes së Ramazanit, në veten tonë, në shtëpitë tona, në lagjet, fshatrat dhe qytetet tona; duke i lyer e pastruar shtëpitë, duke i zbukuruar oborret e duke ndriçuar rrugicat, dyert e ballkonet, sepse Pastërtia dhe Drita janë simbolika të shtrenjta të këtij muaji!

Të dashur vëllezër,

Të parët tanë kanë thënë se “agjërimi ndahet në: të përgjithshëm, të veçantë dhe përtej të veçantit. Agjërimi i përgjithshëm është privimi i stomakut dhe i krejt gjymtyrëve të tjera nga synimi i epshit. Agjërimi i veçantë është privimi i veshit, syrit, gjuhës, dorës, këmbës dhe krejt gjymtyrëve të tjera nga gjynahet. Agjërimi përtej të veçantit është agjërimi i zemrës nga ndjesitë e ulëta dhe ndalimi i saj nga çdo gjë tjetër pos All-llahut, me tërësinë e saj!”⁸

Prandaj, t’i lutemi All-llahut të Madhëruar që me mirësinë e Tij, ta mbërrijmë Muajin e agjërimit. Me begatitë e Tij ndaj nesh, ta agjërojmë Ramazanin, në më të mirën e formave dhe të përfitojmë nga mirësia e tij, faktin se: “Çdo vepër e birit të Ademit është e tij, përveç agjërimit. Ai është i Imi dhe Unë shpërblej për të!...”⁹, siç na mëson Resulull-llahu (a.s), nga Zoti i gjithësisë!

Amin!

*(Hytbe e mbajtur në xhaminë
e fshatit Shtoj i Ri)*

Shkodër, më 5 qershor 2015

arabishtja Ataullah Aliu, LOGOS-A, 2010, f. 68-69.

7. Kur’ani, El-Bekare: 185.

8. Imam Shihabuddinibn Muhammed El-Ebshihi, “El-Mustatraf fi kul-li fennin mustadhraf”, Bejrut, 1981, f. 38.

9. Transmetuar nga Ibn Khuzejme, nga Ebu Hurejra (r.a).



Prim dr. Ali Iljazi

Institucioni i agjërimit na ofron mundësinë që t'i akordojmë natyrës dhe karakteret tona dhe njëkohësisht të zhvillohen tek ne cilësitë e durimit, ekuilibrit, kontrollit dhe vetëpërmbytjes.

Gjatë gjithë jetës njeriu dhe forca e besimit të tij sprovohet me vështirësi, fatkeqësi e prova të vështira, dhe njeriu nëse arrin të triumfojë, atëherë tek ai do të zhvillohet një forcë shpirtërore e cila do ta parandalonte nga mëkatet dhe dëshirat djallëzore.

Është pikërisht ky mesazhi kuptimplotë i agjërimit. Të agjërosh prej të ngrënit, të pirit, dëshirave tunduese, shikimeve provokuese, prej të folurit përgojues, shpifjeve, ofendimeve, sharjeve, prej të menduarit djallëzor, ndaj intrigave, kompleteve dhe prapaskenave, është pikërisht ky dimensionimi i ri i vlerave të karakterit njerëzor.

Agjërimi vendos një ekuilibër të përkohshëm mes trupit dhe shpirtit që ata të përjetojnë së bashku një ekzistencë të harmonizuar paqësore

Kuptimi i vërtetë i fjalës arabe es-saum (agjërim) d.m.th. pushim, qetësi. Kjo d.m.th. që sistemit gastro-intestinal, atij gjenital, gjuhës, syve dhe veshëve, etj. u japim pushim.

Në realitet, agjërimi është një siguri plotësuese për proceset regjeneruese në organizëm. Procesi i regjenerimit të trupit dhe trurit, duke përfshirë molekulat e memories, fillon kur trupi pushon, sidomos gjatë periudhës së gjumit të thellë. Gjumi gjatë Ramazanit është shumë më intensiv se gjumi në periudhat

NDIKIMI I AGJËRIMIT NË PROCESET BIOKIMIKE DHE BIORITËM

tjera. Dy orë gjumë gjatë Ramazanit janë më të ëmbël dhe më të bukur se disa orë në gjendje e muaj të tjerë. Meqë agjërimi nuk kalon 14 orë në ditë, gjendja e qëndrueshme e organizmit është rezultat i mekanizmit të koordinuar psikologjik. Për këtë hulumtimet e bëra në shumë qendra botërore të mjekësisë tregojnë rezultate fantastike biokimike të gjakut.

Gjatë agjërimit, magnezi në serum rritet. Magnezi ka efekt mbrojtës kardiak dhe shfrytëzohet në parandalimin dhe shërimin e sulmeve cardiace.

Ai në vete përmban cilësi anti-platelitale dhe mbron nga përhapja e koagulimit.

Është stabilizator i membranës, i cili ndikon në rrjedhën e sodiumit, potasit dhe kalciumit në nivelin e membranës. Për këtë ai mbron nga aritmitë e zemrës dhe trurit.

Agjërimi nëpërmes efekteve të dobishme të magnezit, parandalon formimin e ateromeve dhe tret pllakat ateromatike, të cilat janë përgjegjëse për sulme në zemër dhe tru. Për këtë agjërimi merr pjesë aktive në këndelljen e trupit.

Magnezi rrit aktivitetin fibrinolitik të gjakut dhe parandalon dhe fibrinlizën e koagulatëve të rinj.

Ramazani ofron shpirt të shëndoshë dhe trup të shëndetshëm. Gjatë agjërimit tajitja e hormoneve nëpërmes gjëndrës së hipofizës rritet, ngase ekziston hormoni anabolik për sintezën e proteinave dhe kolagjenëve i cili prodhon baraspeshën pozitive të azotit. Ai gjithashtu stimulon eritropoezën dhe sintezën e kolagjenit.

Gjatë agjërimit, namazit dhe përvojave të ndryshme shpirtërore në Ramazan, substanca të caktuara endogjene nëpërmes trurit dhe palcës kurrizore lirohen në organizëm.

Këto substanca quhen opoide. Këto përfshijnë enkefalinën dhe endorfinën që janë përgjegjëse për eufori,

qetësi dhe çiltërsi gjatë kësaj periudhe.

Endorfina dhe enkefalina janë dominiues natyral të dhembjes. Endorfina është përgjegjëse për ndjenjën e kënaqësisë të cilën e përjetojnë shumë njerëz pas ushtrimeve të sforcuara. Endorfina dhe enkefalina janë derivate nga beta - lipotropina.

Nëse, p.sh., një atlet lëndohet gjatë garës, ushtari gjatë luftës, ose një njeri që është duke agjëruar, ndoshta ata edhe nuk e vërejnë plagën, përde-

*AGJËRIMI VENDOS
NJË EKUILIBËR
TË PËRKOHSHËM MES
TRUPIT DHE SHPIRTIT
QË ATA TË PËRJETOJNË
SË BASHKU
NJË EKZISTENCË
TË HARMONIZUAR
PAQËSORE*

risa mendi i tyre nuk përfundon. Kjo ndodh për arsye se truri prodhon sasi shumë të mëdha të endorfinës ose enkefalinës në periudhën e stresit intensiv, shqetësimit ose gjatë agjërimit. Agjërimi nxit efektin natriuretik, që e lejon trupin të eliminojë natriumin dhe ujin e tepërt nga organizmi. Kjo lejon zgjidhjen e problemeve kronike me edem, dhe ndihmon në uljen e volumit të rritur të gjakut, bashkë me presionin e lartë të gjakut.

Rekalibrimi enzimatik: Gjatë agjërimit, trupi shton ndryshimet enzi-

matike që ndikojnë në rregullimet e shumë sistemeve si detoksikimi nga substancat helmuese, shpenzimin e rezervave dhjamore dhe rezervimin e proteinave. Ky është edhe shkaku i përmirësimeve në gjendjen klinike të pacientëve.

Atmosfera shpirtërore gjatë agjërit zvogëlon stresin. Stresi ndikon në cilësinë e jetës dhe është shkak potencial për shumë sëmundje.

Detoksikimi: Agjërimi lehtëson dhe mobilizon eliminimin e substancave të dëmshme nga organizmi, si: kolesterina, acidi urik, dioksina dhe mbetje të tjera toksike.

Neuroadaptimi: Agjërimi ndihmon sensorët e shijes që të përshtaten me një nivel më të ulët të kripës që merret me ushqimin. Kjo gjë i mundëson trupit të adaptohet me shpejtësi me një dietë të shëndetshme me më pak kripë.

Agjërimi ka një ndikim normalizues në sistemin nervor. Zvogëlon shqetësimet në sistemin tretës si dhe qetëson gjendjen e ankthit.

Hipertensioni është shkaktar kryesor që kontribuon në vdekjet dhe dëmtimet në shoqëritë e industrializuara.

Në vitin 1984, qendra shëndetësore "Tru North Health Center" në SHBA, bëri një studim me 174 pacientë me hipertension. Kurimi ishte qëndrimi pa ngrënë, vetëm me ujë. 90% të pacientëve u shëruan plotësisht e nuk patën më nevojë për ilaçe.

Gjatë agjërit, palca e kockave (vendi ku prodhohet gjaku) ngacmohet dhe shtohet sasia e prodhuar e gjakut.

Gjatë agjërit ekuilibri i ujit mes

qelizave dhe brenda tyre zbret në minimum. Kështu, në funksionet qelizore ndodh një qetësim i rëndësishëm.

Agjërimi ndihmon në ruajtjen e ekuilibrit mendor dhe trupor si dhe stabilizon efektet e tërheqjes hënore mbi organizëm.

Largimi i Hënës nga Toka, siç ndikon mbi detet dhe oqeanet, po ashtu ndikon dhe mbi trupin e njeriut që ka mbi 70% ujë.

Rekomandohet agjërimi i ditëve 13-14-15 sipas kalendarit hënor, pasi janë ditët kur rritet në maksimum tërheqja hënore dhe efektet e saj negative në organizëm.

AGJËRIMI ËSHTË SEKRET I JETËGJATËSISË

"Po ta dini agjërimi është më i dobishëm për ju." (El - Bekare, 184)

Në realitet, qëllimi i vetëm i krijimit, siç e përshkruan Kurani fisnik, është adhurimi dhe lartësimi i Zotit. Ai është motivi i njohjes, përceptimit të së vërtetës, drejtësisë, dashurisë, mëshirës, vëllazërisë e moralit njerëzor.

Kjo vërtetësi e ka shoqëruar gjithnjë shoqërinë njerëzore me anë të shpalljes hyjnore.

AGJËRIMI DHE BIORITMI

Besimtari i cili që nga fëmijëria ka agjëruar rregullisht, ka qenë i ekspozuar situatave të ndryshme, të ndritshme e të errëta, së paku gjatë një dite të muajit lunar.

Për këtë, pa dyshim, ai shumë më lehtë për shkak të situatave të ndryshme shumë shpejt sinkronizon bioritmin e tij ditor, mujor dhe vjetor.

Kjo orë biologjike kryesore, e cila ka një cikël jetësor prej 24

*GJATË AGJËRIMIT,
TRUPI SHTON
NDARYSHIMET ENZIMATIKE
QË NDIKOJNË
NË RREGULLIMET
E SHUMË SISTEMEVE
SI DETOKSIKIMI
NGA SUBSTANCAT
HELMUESE,
SHPENZIMIN
E REZERVAVE DHJAMORE
DHE REZERVIMIN
E PROTEINAVE.
KY ËSHTË EDHE SHKAKU
I PËRMIRËSIMEVE
NË GJENDJEN KLINIKE
TË PACIENTËVE.*

orësh, është e vendosur në nukleusin hipotalamik. E përbërë prej 10.000 nervave, ndodhet tre centimetra pas syrit (myasma opticus).

Myslimanët të cilët kanë pasur çrregullim të cikleve ditore zgjuar/gjumë, gjatë një viti hënor, por rregullisht kanë agjëruar, më shpejt adaptohen në kushtet e ndryshme të udhëtimit ndërkombëtar.

Ata nuk kanë kurrfarë pengesash, përderisa kalojnë zonat kohore dhe



nuk vuajnë nga sëmundjet dhe lodhjet të cilat përjetohen pas udhëtimit të gjatë me aeroplan.

Menjëherë, posa të përfundojë Ramazani, ritmi i ciklit normal jetësor, i cili te agjëruesit zgjat 24 orë, ditën e parë të muajit tjetër - shevval, me shpejtësi të madhe ekuilibrohet.

Kjo d.m.th. që bioritmi në Bajram arrin të njëjtin nivel të para Ramazanit.

Për resikronizimin e punëtorëve në ndërrimet e punës nevojitet periudhë prej tri javësh.

Meqë myslimanët të cilët agjërojnë, vetvetiu adaptojnë procesin e resikronizimit gjatë periudhës e cila zgjat katër javë në Ramazan, problemet shëndetësore të tyre (që kanë punëtorët e punës me ndërrime) janë të parëndësishëm.

DOBITË E NAMAZIT TË NATËS

Përveç kësaj, kontaktet shoqërore gjatë teravisë apo namazit të natës si dhe aktivitetet tjera shoqërore-shpirtërore veprojnë si dhurues i kohës (zeitgeber). Ai rregullon ritmet biologjike të desinkronizuara.

Gjatë vitit, myslimani i rëndomtë, kryen obligimin e tij ditor (namaz) pesë herë. Kjo praktikë i jep aftësi fizike secilit muskul në trup. Gjatë muajit të agjërit namazet shtesë si ai i teravisë dhe i natës, shpenzojnë afër 200 kalori.

Kjo praktikë shpenzon të gjitha ekstra kaloritë që futen gjatë iftarit. Njëkohësisht glukozja në gjak rritet, ndërsa gjatë namazit ajo oksidohet në CO₂ dhe H₂O.

Lëvizjet fizike gjatë namazit nafile japin ndjenjën e fleksibilitetit, koordinimit dhe relaksimit. Ai, gjithashtu, zvogëlon stresin, mënjanon brengën

dhe depresionin.

Gjatë faljes së teravisë (kijam) taji-tet adrenalini dhe moradrenalini. Ata janë përgjegjës për dinamizëm konstant, i cili kombinohet me qetësi dhe çiltërsi si pasojë e sekrecionit të enkefalinës, endorfinës, dinorfinës, etj.

Kjo e bën namazin e natës të pashembullt, në kuptimin që te i njëjti individ kombinohet dinamizmi me çiltërsinë, euforinë dhe dinjitetin.

Është vërejtur se gjatë aktivitetit të vazhdueshëm, efekti i adrenalinit dhe moradrenalinit mbetet për një kohë të gjatë pas përfundimit të namazit të natës.

Bile edhe sjellja e njetit për namaz ka pjesëmarrje në aktivizimin e sistemit nervor simpatik.

Lëvizjet e rregullta dhe të sinkronizuara të trupit gjatë namazit ofrojnë fuqinë e muskujve, elasticitetin, fleksibilitetin e nyjave dhe rezervës kardiovaskulare.

Lëvizjet e trupit ndihmojnë parandalimin e osteoporozës te të mos-huarit.

Forcimi i pompës së muskujve të nëngjunjëve me lëvizje aktive të nyjave në këmbë, parandalon trombozën e thellë të venave.

Ushtrimet mbrojnë organizmin nga sëmundjet kronike të zemrës, duke shtuar tolerancën e karbohidrateve si dhe parandalimin e diabetit të tipit 2.

Rritja e nivelit të hormoneve gjatë agjërit dhe ushtrimeve gjatë namazit të natës, është i rëndësishëm për formimin e kolagjenit i cili është faktor i rëndësishëm për formimin e vonshëm të rrudhave në lëkurë.

Ushtrimet dhe lëvizjet që bëhen gjatë namazit të natës (kijamul-lejl) i japin njeriut humor të mirë, medi-

tim konstruktiv dhe sjellje të pëlqyeshme.

Përsëritja e namazit, lutjet, dhikri dhe aktivitetet e muskujve, shkaktojnë relaksim, zvogëlojnë konzenimin e oksigjenit dhe reduktimin e aktiviteteve kardiorespiratore.

Lutjet në Islam janë të veçanta; të kombinuara me lëvizjet ritmike të trupit dhe meditimin e koncentruar, japin një model të veçantë të relaksimit dhe qetësisë psikofiziologjike.

Roli edukativ i jetës në aspektin moral ka karakter multidimensional. Ai krijon një lidhje dhe marrëdhënie e devotshmërisë mes njeriut dhe Zotit, mes individit dhe anëtarëve të shoqërisë dhe mes njeriut dhe natyrës së tij të brendshme shpirtërore.

Në këtë mënyrë agjëruesi kontrollon sjelljen e tij të jashtme, shfaqjen dhe manifestimin e veprave të tij, fjalët, mendimet, ndjenjat e qëllimet dhe kështu roli i tij në jetën shoqërore bëhet tejet i rëndësishëm dhe konstruktiv.

Ai në sjelljen dhe karakterin e tij, shpalos drejtësinë, të vërtetën dhe lufton padrejtësinë dhe vlerat e rrejshme.

Por, theksojmë se forca dhe energjia shpirtërore nuk mund të përfitohen nga agjërimi dhe roli i tij edukativ nuk mund të konceptohen, nëse ai nuk kryhet me bindje dhe përkushtim.

Meqë gjendemi së bashku në mua-jin e paqes, mëshirës dhe lutjes, t'i lutemi Atij me bindje e përkushtim që të na udhëzojë në udhën e drejtë të idealit e të na dhurojë paqe e begati dhe të na bëjë të devotshëm.





Admir Plaku

Imam, xhamia "Ebu Bekr"

Me ardhjen e muajit të Ramazanit besimtarët janë të privilegjuar me mëshirën e Allahut (xh.sh), falë agjërimit dhe respektimit të dispozitave të tij. Agjërimi është një obligim i njohur edhe nga popujt e mëparshëm, ithtarë të Librit. Për këtë Allahu (xh.sh) thotë: “O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush.”¹ Si vërehet agjërimi është një urë lidhëse mes popujsh e gjenerata besimtarësh gjatë historisë së njerëzimit.

Në kryerjen e këtyre obligimeve si namazi, agjërimi, kurbanit etj, Allahu (xh.sh) e dalloj ymetin e Muhammedit (a.s) duke ia lehtësuar kryerjen e tyre. Kështu e dalloj dhe lehtësoi agjërimin e këtij ymeti me ngrënien e bereqetshme të syfyrit. Meqenëse më parë nëse dikush flinte pa ngrënë, e kishte të ndaluar të hante apo pinte deri në mbrëmjen e së nesërme.

Kur Pejgamberi (a.s) urdhëroi për të ngrënë syfy, kjo ngrënie u bë simbolikë e agjërimit të muslimanëve. Në këtë kontekst Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Dallimi mes agjërimit tonë dhe agjërimit të ithtarëve të Librit është ngrënia e syfyrit”.² Në aspektin e dispozitave juridike të Islamit, ngritja për syfy para se të hyjë koha e agjërimit është mustehab (e pëlqyeshme). Pejgamberi (a.s) i ka kushtuar një rëndësi të veçantë ngrënies së syfyrit, për faktin se në të ka mirësi.

Besimtarët nuk duhet ta humbasin apo neglizhojnë syfyryn gjatë agjërimit të Ramazanit, sepse duke mos

SYFYRI, NGRËNIA E BEREQETSHME

respektuar kohën e ngrënies së syfyrit jemi larguar nga mëshira e Allahut (xh.sh). Ndodh që në mesin tonë ka nga ata besimtarë që e nënvleftësojnë këtë ngrënie, në këtë kohë të bereqetshme, por kjo nuk është prej sunetit të Pejgamberit (a.s). Prandaj e ndjej si obligim të citoj disa mirësi të ngrënies së syfyrit:

1. Allahu (xh.sh) fal, ndërsa melekët e Tij bëjnë lutje për besimtarët që hanë syfy.

Allahu (xh.sh) i përfshin në mëshirën e tij besimtarët që ngrihen në syfy, ndërsa melekët bëjnë lutje për ta që t'u falen gjynahet. Transmetohet se Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Ngrënia e syfyrit është bereqet, ndaj mos e lini atë, qoftë edhe me pirjen e një gllënjke ujë, sepse Allahu (xh.sh) i fal ata që hanë syfy dhe melekët e Tij bëjnë lutje për ta.”³

2. Koha e syfyrit është koha e lutjeve të pranuar.

Prej mirësive që ngrënia e syfyrit mbart në brendinë e vet është edhe koha e mirë për t'u lutur, të cilën Allahu (xh.sh) ua vë në dukje besimtarëve. Në lidhje me këtë thotë: “Dhe në syfy (nga mbarimi i natës) ata kërkojnë falje për mëkatet.”⁴

3. Ngrënia e syfyrit është bereqet.

Duke komentuar thënien e Pejgamberit (a.s): “Bëni syfy, se në syfy ka bereqet”⁵, dijetari Ibn Arabij (Allahu e mëshiroftë) thotë: “Allahu (xh.sh) na ka mëshiruar me lejimin e ngrënies së syfyrit pasi ishte i ndaluar për ithtarët e Librit para nesh. Me këtë dispozitë na dalloj dhe respektoi Muhammedin (a.s). Prandaj kush nuk e respekton këtë qoftë edhe me një gllënjke ujë, nuk është prej nesh.” Vërtetë që syfyri është bereqet dhe kjo duket qartazi në pesë këndvështrime:

- Është lehtësim për agjëruesin.
- Është pasim i traditës profetike.
- Është tregues devotshmërie në mënyrën e kryerjes së agjërimit.
- Është simbolikë e dallimit të

agjërimit të muslimanëve nga ithtarë të Librit.

- Me ngrënien e syfyrit, agjëruesi është më i fortë për të tejkaluar vështirësitë që hasen gjatë agjërimit.

Lexues të nderuar, mos i humbisni këto mirësi të ngrënies së syfyrit. Allahu (xh.sh) e ka begatuar kohën e fillimit dhe mbarimit të ibadeteve tona. Vlerësimi i fillimit të ibadetit është tregues besimi për besimtarët. Le të jetë ngrënia e syfyrit për secilin nga ne, një fillim i mbarë i agjërimit. Si është e preferuar ngrënia e syfyrit ashtu është e preferuar edhe vonimi i tij.

Brezat e parë të besimtarëve kanë genë të kujdesshëm në ruajtjen e fillimit apo mbarimit të agjërimit. Ky interesim shihet qartë edhe në hadithet

“Ngrënia e syfyrit është bereqet ndaj mos e lini atë, qoftë edhe me pirjen e një gllënjke ujë, sepse Allahu (xh.sh) i fal ata që hanë syfy dhe melekët e Tij bëjnë lutje për ta.”

profetike. Transmetohet nga Enesi (r.a) se Zejd ibn Thabit (r.a) ka thënë: “Kemi ngrënë syfy me Pejgamberin (a.s), pastaj ai u ngrit për të falur namazin e sabahut.” Enesi i tha Zejdit: Sa ka genë koha mes ezanit dhe syfyrit? Tha: Sa të lexuarit e pesëdhjetë ajeteve kuranore.”⁶ I njëjti interesim duhet të ekzistojë edhe tek besimtarët e ditëve të sotme. Të jenë sa më të vetëdijshëm ndaj obligimeve hyjnore.

Së fundmi lutem që agjërimi i këtij Ramazani të jetë i lehtë dhe i pranuar për gjithë besimtarët kudo që ndodhen.

1. Kur'ani, El-Bekare: 183.

2. Transmeton Muslimi, Ebu Davudi dhe Tirmidhiu.

3. Transmeton Ahmed.

4. Kur'ani, Edh-Dharijat: 18

5. Muttefekun alejhi.

6. Muttefekun alejhi.

AKTIVITET TË RAMAZAN



E NË PRAG

NIT 1436/2015





Sheikh Vehbi S. Gavoçi

Cilësitë e sjelljet e këtij njeriu të lartë përmenden si shembuj të bukur pozitivë, qoftë për lutje e frikë nga Zoti (xh.sh), nga interesimi për popullin e drejtësi për të gjithë, qoftë sepse jetonte vetë me një rrogë të vogël, qoftë me zemrën e butë që qante shumë herë, qoftë edhe për qëndrimin e rreptë kundër keqbërësve, derisa të siguronte të drejtat e njerëzve të dëmtuar prej tyre etj.

Ne këtu po paraqesim disa prej tyre si shembuj ilustrues.

1. Erdhi Umrani, djali i Husejnit, në Medine dhe ra te nipi i tij Hurr, djali i Kajsit. Hurr-ri ishte anëtar në këshillin që kishte formuar Hz. Umeri për të plotësuar nevojat e vendit e kërkesat e popullit. Një ditë Umrani i kërkoi leje Hurr-rrit të marrë pjesë edhe ai në mbledhjen e këshillit. Kjo kërkesë e tij u pranua. Në një mbledhje të këtij këshilli Umrani u shpreh: Umer, ti as nuk na jep shumë, bile edhe nuk gjykon me të drejtë.

Hz. Umeri u skuq për atë akuzë të rëndë dhe u hidhërua. Hurr-ri vazhdoi: Hej i pari i besimtarëve, Zoti (xh.sh) ka thënë: Fali të tjerët, urdhëro me të mirë, atyre mendjelehtëve sjellu shpinën. Hz. Umeri në këtë çast u zbut, mbasi dëgjoi versetin e shenjtë të Kur'anit të bekuar.

2. Asbegu, djali i Nebates, kallëzon: Erdha me babain tim në Medine për të shitur disa dhen. Në pazar të Medines na i bleu dhentë një njeri, të cilin e njohëm më vonë se ishte Hz. Umeri. Hz. Umeri sillej në treg, vërente sjelljet e njerëzve në blerje e shitje (marrëdhëniet tregtare). Ata që nuk dinin, i mësonte, kush gabonte, u mësonte rrugën e drejtë.

Hz. Umeri i bleu dhentë pa dhënë çmimin menjëherë. Baba i priti pak,

CILËSITË E HZ. UMERIT (R.A)

u mërzit, mandej lyp i nga Hz. Umeri vleftën e tyre. Hz. Umeri i kërkoi babait të presë edhe pak, mirëpo babai e zuri Umeri prej rrobave në gjoks e i tha: Më gënjeve e më bërë zullum (dëm).

Në këtë çast u çuan sahabet të hidhëruar, e larguan babain nga Hz. Umeri e i thanë: Hej armiku i Zotit, kështu silllesh me Umerin?

Umeri shpejt e shpejt e kapi babain tim, e ngriti prej rrobash me forcë, derisa mbërrini te një kasap. Kur shkuan para tij, Umeri i tha: Jepi këtij njeriu vleftën e dhenve. Kasapi bëri vlerësimin e duhur të dhenve.

Mbasi mori babai im të drejtën e vet, u suall Hz. Umeri nga ai e i tha: Ti e more të drejtën tek unë, tani mbeti e drejta ime tek ti, unë të fala për hir të Zotit (xh.sh).

3. Abdull-llahi, djali i Hz. Umerit gjatë luftës kaloi në disa vende të largta. Kur u kthye, shokët e tij i propozuan që të blinte disa deve, mbasi shiteshin lirë në këtë vend, për t'i shitur më shtrenjtë në Medine. Abdull-llahi bleu një sasi dhe i solli me vete në Medine. Më vonë i nxori në treg për t'i shitur. Hz. Umeri, siç e kishte zakon, u gjend në treg për të vëzhguar marrëdhëniet e shitblerjes, të tregtisë mes qytetarëve e udhëtarëve të ndryshëm. Kur pau ato deve të shëndosha, pyeti: -Të kujt janë këto deve?

Mori përgjigje se janë të djalit të tij. Thirri të birin, mësoi prej tij rrethanat e arsyt e blerjes dhe qëllimin e shitjes. Hz. Umeri iu drejtua të birit: -Njerëzit të preferojnë nga të tjerët, u lejojnë deveve tua të pinë ujë më parë se devet e të tjerëve, ashtu ngjet edhe me kullotjen e tyre, mbasi ti je djali im. Duke vepruar në këtë mënyrë, ti ndoshta shkel të drejtat e të tjerëve.

Më vonë iu drejtua djalit me këto fjalë: Shiti devet, merr sa ke paguar, fitimin derdhe në arkën e shtetit. Ashtu u bë.

Sa e sa njerëz fitojnë shumë, mbledhin pasuri, se janë fëmijë të drejtuesve shtetërorë, ose më të mëdhenj se të tjerët, siç kemi parë e dëgjuar, siç ka ndodhur, ndodh e mund

të ndodhë. Veprimi i Hz. Umerit është një mësim i duhur në këtë drejtim.

PASTROI GADISHULLIN ARAB NGA ÇIFUTËT

Historia tregon se disa qindra çifutë patën ikur në Medine për shkak të romakëve, të cilët i ndëshkuan, i vranë, e prenë shumë prej tyre. Këtu çifutët, u munduan të sundojnë Medinen me anë të tregtisë e ushtrisë, për të realizuar interesat e tyre. Kur erdhi Profeti (a.s) në Medine, i bashkoi besimtarët si vëllezër dhe bëri marrëveshje me idhujtarët për të qenë të gjithë të bashkuar kundër çdo armiku që synon keq për çdo grupim të njerëzve në Medine.

Hz. Aliu (r.a) ka thënë:

“Më i miri njeri

mbas Profetit (a.s)

ka qenë Ebu Bekri (r.a),

më i miri njeri

mbas Ebu Bekrit

është Umeri.”

Çifutët, nuk u ndihmuan besimtarëve në luftën e Uhudit, e cila u bë në tokë të Medines, por më tepër ngacmuan besimtarët, mbytnë një musliman, bile deshën të mbysin vetë Profetin (a.s). Ranë dakord me 10.000 ushtarë të ardhur nga Meka për të luftuar Profetin, duke premtuar se do ta hapnin kufirin e tyre që t'u binë ata besimtarëve mbas shpine. Çifutët që bënë atë tradhti të madhe, morën çka merituan.

Kështu pra, nga dëmet që sollën çifutët e Kajnukahit, Profeti iu dha

liri të largohen nga Medineja me çka kishin, me përjashtim të armëve. Çifutët që u larguan nga Medineja shkuan në Khajbar e Tejma para se të vdesë Profeti (a.s)

Prej aty mundoheshin, si përpara të dëmtonin muslimanët, të grumbullonin armiqte kundër tyre, prandaj Profeti (a.s), para se të vdiste, porositi që të largohen çifutët nga gadishulli arab, mbasi me ta nuk mund të bashkëjetonin. Hz. Umeri zbatoi atë kërkesë Profetike me pëlqimin e këshillit të vet e jo vetëm të tij.

Për këtë lajmëroi në Khajber për vendimin që u mor e iu tha: Ai që ka besuar Profetin (a.s), le të qëndrojë ku është, të tjerët të bëhen gati për t'u larguar nga ai qytet. Kështu pra që Z.Umeri, ai burrë i madh, i cili pastroi Gadishullin Arab nga çifutët.

LUFTA NË FENË ISLAME

Lufta në fenë Islame nuk ka qenë për të sunduar popujt e tjerë, për të pushtuar vendet e të tjerëve, për të zbritur të lartin e për të lartësuar të ultin. Nuk ka qenë për të vrrarë e për të prerë, për të zhdukur e për të dënuar të tjerët për hir të perandorisë, të vendit ose të kombit. Nuk ka qenë luftë për të përbuzur të tjerët, për të ndaluar lirinë fetare të të tjerëve, për të grabitur të mirat e vendeve të huaja. Shkurt, nuk u ngjan luftërave që njihen në kombe e popuj të tjerë.

Lufta në fenë Islame është bërë vetëm për të mbrojtur fenë e të drejtat e popullit kundër armikut të brendshëm, fqinj ose të largët. Lufta në fenë Islame ka qenë për të ruajtur lirinë e zgjedhjes së popujve që pëlqejnë Islamin, që të mos torturoheshin e të mos luftoheshin nga sunduesit jobesimtarë ose prej sunduesve të tjerë absolutë.

Lufta në fenë Islame është bërë për të hapur rrugën, që njerëzit ta njihnin fenë Islame, mandej të ishin të lirë të besonin ose të mos besonin. Kështu qenë luftërat Islame që në ditët e para që ndriçuan e shkëlqyen zemrat, jetën e njerëzve, ata përhapën dijen e besimit para syve të popullit për një jetë më të mirë.

Gjithë ata popuj me besime të ndryshme rrojnë bashkë. Historia nuk tregon se një popull ose person është përdhunuar të pranojë fenë Islame, jo më të torturohej, të burgosej, të lihej



pa ngrënë e pa pirë, pa shkollë, pa mundësi pune e tregtie, që dëshiron njeriu jo musliman. Kurse të tjerët kanë mbytur, kanë djegur e kanë pushkatuar mbas torturash të papërshkrueshme, më parë e tani. Një provë e freskët dhe e qartë për këtë është qëndrimi çnjerëzor i serbëve kundër muslimanëve në Bosnje-Hercegovinë.

Për të gjitha këto veprime çnjerëzore ndaj muslimanëve, Zoti (xh.sh) dënon fajtorët në këtë jetë e në jetën e ardhme. Shkurtimisht mësuam për luftërat e ndryshme që u zhvilluan në kohën e Profetit (a.s) dhe të kalifëve mbas tij.

Më i afërti e i sakti fakt është se këto luftëra nuk kanë qenë për të detyruar të tjerët për të hyrë me forcë në Islam, është se në çdo vend arab e musliman jetojnë prej qindra vitesh jo muslimanë, kurse është shumë vështirë të gjesh në Spanjë person ose familje muslimane, megjithëse atje para disa shekujsh kanë qenë miliona të tillë.

HZ. UMERI NË GOJËDHËNAT E SAHABEVE

Hz. Aliu ka thënë: "Më i miri njeri mbas Profetit (a.s) ka qenë Ebu Bekri (r.a), më i miri njeri mbas Ebu Bekrit është Umeri."¹

Kur u vendos në teneshir (tabut) në xhami të Profetit (a.s), Hz. Aliu (r.a) tha: "Zoti (xh.sh) të dhashtë mëshirë, nuk ka krijuar Zoti njeri që dëshironte të dalë me punët e tij mbas Profetit (a.s), se sa Umerin."²

Abdull-llahi, djali i Mesudit, ka thënë: "Sikur të peshohet dija e Umerit

me dijen e të gjithë njerëzve, dija e tij do të dalë më e madhe. Njerëzit kanë thënë se kur vdiq ai, shkuan nëntë nga dhjetë pjesët e dijes."

Ab-basi (r.a) ka thënë: "Kam qenë fqinj me Hz. Umerin, nuk kam parë njeri më të mirë se atë. Natën e kalonte në falje, ditën agjërueshëm dhe me plotësimin e nevojave të popullit."

Shifa, vajza e Abdull-llahit, ka thënë: "Umeri ka qenë burrë, kur fliste, i dëgjohej qartë zëri, kur ecte, shpejtonte përpara, dënonte sipas fajit. Ai ishte besimtar i vërtetë."³

FUNDI I HZ.UMERIT

Hz. Umeri doli në xhami për të falur sahabun si imam. Ndërsa ishte duke rregulluar rreshtat e besimtarëve, e sulmoi Ebu Lulu, një persian, me një thikë e i ra tri herë në bark. Hz. Umeri ra në tokë. Krimineli mbyti 7 vetë dhe plagosi 6 të tjerë. Kur panë sahabet se ky po dëmtonte kaq keq, njëri prej tyre i hodhi një mbulesë, e mbështolli me të, kështu iu zunë duart.

Atëherë ai mbyti veten. 13 kufoma u shtruan në tokë. U çua Abdull-llahi, djali i Eufit, e fali sabahun, mandej u interesua për të vrrarët. Umeri kishte humbur ndjenjat. Mbas pak erdhi në vete e tha: Ai që nuk falet, nuk ka fat në Islam. E çuan në shtëpi, ku mori abdes e u fal, ndërsa gjaku i rridhte pa pushim. Mbasi kreu këtë detyrë, pyeti: Kush më qëlloi? I thanë: Filani. Umeri u shpreh: Shyqyr që nuk më qëlloi një që është falur një ditë, mjerë ai, unë mendova ta bëja të mirë.

Mbas pak vdiq Hz. Umeri, në moshën 63-vjeçare dhe u varros në fund të këmbëve të Profetit (a.s).

1. Ibn Maxhe.

2. "Historia e Kalifëve".

3. El-Hilje.

MYFTIU PRITI ZV/MINISTRIN E VAKËFIT TË KUVAJTIT, DR. ADIL EL-FELAH

Paraditën e së mërkurës, më 20 maj 2015, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, priti në një takim të përziemert e miqësor, Shkëlqesinë e Tij, dr. Adil Abdullah El-Felah, zv/ministër i Çështjeve të Vakfit në Shtetin e Kuvajtit, që shoqërohej nga drejtori i AIITC, dr. Ramiz Zekaj.

Pas urimeve të mirëseardhjes, Myftiu shprehu kënaqësinë e tij për këtë vizitë të zv/ministrit të Çështjeve të Vakfit në Shtetin e Kuvajtit, duke shprehur njëkohësisht vlerësimet e tij për kontributet e mëdha që Shteti i Kuvajtit ka dhënë për rimëkëmbjen e vlerave islame në Shqipëri, sidomos pas vitit 1990, kur edhe u rilejua me ligj praktikimi i lirë i besimit dhe fesë.

Njëkohësisht, Myftiu e informoi z. El-Felah me aktivitetin e Myftinisë Shkodër dhe vështirësitë e shumta të saj, në rrugën e gjallërimit të mëtejshëm të Thirrjes Islame.

Nga ana e tij, zv/ministri i Çështjeve të Vakfit në Shtetin e Kuvajtit, dr. Adil El-Felah, shprehu kënaqësinë e tij për këtë vizitë në Shkodër, ku theksoi se



bashkëpunimi në mesin e muslimanëve është domosdoshmëri, në rrugën e rimëkëmbjes së vlerave të larta qytetëruese të Islamit në mbarë botën.

Me rastin e kësaj vizite, Myftiu i Shkodrës, i dorëzoi z. El-Felah një Dëshmi “Mirënjohjeje”, me dedikim: “Për kontributin e madh dhe të vyer në përhapjen e vlerave të moderacionit dhe drejtësisë në Thirrjen Islame, në mbarë botën”.

Më pas, me ftesë të Myftiut, zv/ministri i Çështjeve të Vakfit në Shtetin

e Kuvajtit, mbajti një ligjëratë në xhaminë e “Dy Vajzave”, ndërtuar me kontribute bamirëse nga Kuvajti.

Në fjalën e tij para besimtarëve të pranishëm, dr. Adil El-Felah bëri thirrje që muslimanët të pastrojnë zemrat në marrëdhënie me njëri-tjetrin, të afrohen përherë e më shumë me shembullin e personalitetit të Hz. Muhamedit (a.s), si dhe të dëshmojnë vlerat e harmonisë së besimit islam, edhe në raport me besimtarët e feve të tjera, kudo në botë.

IMAMËT E SHKODRËS, TË BARTIM ME DINJITET AMANETIN E THIRRJES ISLAME!

Ditën e enjte, më 28 maj 2015, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, zhvilloi një takim pune me një grup imamësh të Myftinisë Shkodër.

Myftiu diskutoi mbi zhvillimet e fundit në vend, atmosferën e prag Ramazanit, sikurse dha udhëzime që lidhen me predikimet fetare dhe gjuhën e tyre.

“Duhet të jemi të vëmendshëm për atë që themi dhe si e themi, sepse kjo është kohë intrigash dhe sprovash, ku e keqja përpiqet me të gjitha mënyrat për të shfrytëzuar hapësira të mundshme, kundër Islamit dhe muslimanëve në këtë vend dhe në mbarë botën. Kjo na obligon të përqendrohemi edhe më shumë tek tematika e forcimit të vëllazërisë islame dhe rritjes së harmonisë në mes vete.

Prandaj, ne duhet të bëjmë detyrën tonë dhe të bartim me dinjitet amanetin e Thirrjes Islame, të cilës i jemi kushtuar! Ditë pas dite po dëgjojmë të flitet për terrorizmin, ekstremizmin fetar, e të ngjashme.

E kemi për detyrë të distancohemi publikisht ndaj thirrjeve të dhunës, terrorit, ekstremizmit, që fatkeqësisht, dikush i përdor sot edhe në emër të Islamit. Por, Islami është i pastër nga fëlliqësia e injorancës, nga terrorizmi dhe ekstremizmi, nga mosrespektimi i të drejtave të njeriut dhe intoleranca ndërfetare! Ne jemi thirrës islamë dhe detyra e jonë është shumë e rëndësishme, sidomos në mësimin e njerëzve dhe qartësimin e tyre se Islami është fé e dijes, e drejtësisë, e bamirësisë, e lartësimit të njeriut në rangjet më të larta të besimit, larg dhunës, urrejtjes, ekstremizmit!”, -

tha Myftiu në fjalën e tij.

Ai theksoi se është e domosdoshme të respektohet detyra e imamit në shërbim të komunitetit dhe besimtarëve.

Myftiu tha se ditëve të fundit, fushatat e islamofobisë janë shtuar, por detyra e jonë është të dëshmohej njerëz të ekuilibruar, thirrës drejt dijes, harmonisë brenda komunitetit tonë dhe përhapës të denjë të vlerave islame në shoqëri.

Në këtë takim, Myftiu lexoi edhe qarkoren e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë drejtuar krejt myftinive të vendit, në lidhje me votimet e 21 qershorit dhe qëndrimin ndaj tyre.

Në fund, u diskutua edhe rreth kërkesave dhe shqetësimeve të shfaqura nga imamë të ndryshëm, mbi aktivitetin fetar dhe gjallërimin e mëtejshëm të jetës fetare në Shkodër.

MOTRAT MUSLIMANE PËRKUJTOJNË NATËN E GJYSMËS SË SHABANIT

Në atmosferën e aktiviteteve që shoqërojnë ardhjen e Muajit Ramazan, ditën e hënë, më 1 qershor 2015, Myftinia Shkodër organizoi një aktivitet fetar për motrat muslimane, në xhaminë e Tophanës.

Në qendër të këtij aktiviteti ishte përkujtimi i Natës së Gjysmës së Shabanit, si një natë rreth mirësisë së cilës janë transmetuar shumë hadithe, ndërkohë brezat e mëparshëm e kalonin në adhurim, me dhikër, istigfar e lexim Kur'ani.

Motrat e pranishme janë nxitur që të jenë të vëmendshme për të përfutur sa më shumë nga këto mirësi që vijnë herë pas here, si dhurata e begati hyjnore për besimtarët.

Në këtë tubim vlerash besimi, kanë ligjëruar vaizet e Myftinisë Shkodër, teologët Ferzet Ndoja, Zamira Bushati dhe Jetmira Plaku, të cilat kanë hedhur dritë mbi mirësinë e këtyre ditëve, në



prag të muajit Ramazan dhe rëndësinë që ka shfrytëzimi i tyre, për të shtuar adhurimet dhe lutjet.

Gjatë këtij aktiviteti është folur edhe mbi rëndësinë dhe vlerën e Muajit Ramazan dhe angazhimit maksimal që duhet të ketë muslimani për të përfutur

në mënyrë të vazhdueshme nga mirësitë pafund të këtij muaji të begatë.

Aktiviteti është pasuar me disa recitime fetare dhe me duanë e hatmes sherife, të bërë nga vaizet e nderuara, nënat dhe motrat muslimane të pranishme në këtë aktivitet të dobishëm fetar.

GURI I ZI, LIGJËRATA: “VLERA TË AGJËRIMIT TË RAMAZANIT”

Ditën e martë, më 2 qershor 2015, pas namazit të iqindisë, në xhaminë e fshatit Guri i Zi, u zhvillua një tribunë fetare, ku Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, mbajti një ligjëratë mbi rëndësinë e agjërimit dhe disa nga vlerat e Muajit Ramazan.

Fillimisht, Myftiu theksoi se tashmë, që kaluam edhe Natën e Gjysmës së Shabanit, atmosfera e muajit të agjërimit, sa vjen dhe afrohet dhe mbulon gjithësinë me pelerinën e bekimeve hyjnore, që afrojnë zemrat e besimtarëve me përshtirësinë e Ramazanit.

Myftiu trajtoi temën e përkushtimit në jetë, duke u ndalur tek përkushtimi ndaj Zotit dhe ai ndaj njeriut në jetë. “Është shumë me rëndësi të kuptojmë dhe të ndjejmë se Ramazani nuk është një muaj i zakonshëm, ku ne si besimtarë jemi të ftuar të rrimë thjeshtë pa ngrënë e pa pirë në një orar të caktuar ditor. Jo! Qëndrimi pa ngrënë e pa pirë në orare të paracaktuara, është simbolikë e forcës së besimit dhe ndërgjegjes së besimtarit, që për hatrin e Zotit privohet nga ushqimi, pija dhe kënaqësi të tjera materiale, në mënyrë sistematike, në kuadrin e një muaji kalendarik, me qëllim dëshmimin e forcës së besimit



dhe rritjen e tij shpirtërore.

Agjërimi i Ramazanit është një mundësi më shumë për secilin prej nesh për ta dëshmuar haptas besimin dhe përkatësinë e tij islame, pa ndrojtje dhe pa komplekse! Prandaj, unë ju ftoj ta përhapni gëzimin dhe shpirtin e bukur të këtij muaj në familjet tuaja, në rrugët e lagjeve, në rrugicat e fshatit, në çdo mënyrë të mundshme, që kushdo që kalon nga kjo zonë, të kuptojë se muslimanët janë në festë, në gëzim, në një muaj bekimesh!”, - tha ndër të tjera Myftiu.

Ky tubim u parapri nga fjala e imamit të xhamisë, z. Bujar Ymeri, që vuri

theksin te domosdoshmëria e jetës së xhamisë me takime të ndryshme, ku përkujtojmë mirësitë e All-llahut dhe vlerën e besimit në jetën tonë.

Imami falënderoi të pranishmit dhe theksoi se xhamia e fshatit Guri i Zi, po përgatitet për të përjetuar një muaj të madhërishtë, me programe e aktivitete, që do ta gjallërojnë edhe më shumë jetën fetare në këtë fshat.

Për të pranishmit, u shpërndanë edhe disa botime të Myftinisë Shkodër, që lidhen me agjërimitin e Ramazanit dhe dërgesën profetike të hz. Muhammedit (a.s.).

KRYETARI I KMSH, SKËNDER BRUÇAJ, VIZITË PUNE NË MYFTININË E SHKODRËS

Ditën e enjte, më 11 qershor 2015, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Skënder Bruçaj, zhvilloi një vizitë pune në Myftininë e Shkodrës.

Në këtë vizitë, Kryetari i KMSH, shoqërohej nga antarët e kryesisë së KMSH, z. Genti Kruja (drejtor i kulturës dhe dialogut ndërfaqetor) dhe z. Uran Kalej (drejtor i vakëf/investime).

Në shoqëri të Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, Kryetari i KMSH zhvilloi një inspektim në disa prej vakëfeve të qytetit të Shkodrës, si dhe në lagjen Zogaj, ku u njoh nga afër me arritjet e deritanishme dhe problematikat e shfaqura në këto vakëfe.

Gjatë vizitës së xhamisë së re në lagjen Dudas, Kryetari Bruçaj shprehu vlerësimet e tij për ndërtimin e kësaj xhamie të bukur, që do të shërbejë shumë mirë për banorët e lagjes muslimane të Dudasit.

Ai theksoi se ky Ramazan, do të ketë një kuptim më të veçantë për këta banorë, që do të kenë mundësi të falen në xhaminë e tyre të re, që është ndërtuar falë bashkëpunimit të Myftinisë Shkodër me Fondacionin “Mirësia”.

Më pas, u zhvillua një vizitë edhe të



xhamia e re e “Dy Vajzave”, ku u vlerësua kompleksi i bukur i kësaj xhamie, që përbëhet nga faltorja, klasat për mësimin e nxënësve, dyqanet, abdes’hanja, mafli i grave, ballkonet dhe korridoret e bollshme, që të krijojnë frymëmarrje dhe të dhurojnë qetësi.

Kryetari dëgjoi me vëmendje shpjegimet e imamet të kësaj xhamie, teologut Lavdrim Hamja, që theksoi se fryma e bukur e bashkëpunimit dhe harmonisë që po krijohet në këtë xhami, ka një vlerë të madhe që i shtohet mozaikut të harmonisë islame në Shkodër.

Një inspektimi i veçantë ishte ai i zhvilluar në lagjen Zogaj, ku pas namazit të iqindisë, Kryetari i KMSH u njoh me hollësi dhe detaje të peripecive të shumta që ka kaluar Myftinia Shkodër deri në posedimin e disa prej tapive legjitime të saj në këtë vakëf të madh.

U bë evident edhe pretendimi i Myftinisë Shkodër për një pjesë të zaptuar të vakëfit në këtë lagje, si dhe u diskutuan ide dhe mendime, në funksion të shfrytëzimit sa më efikas të këtij vakëfi të shenjtë.

“NDIKIMI I AGJËRIMIT NË PROCESET BIOKIMIKE DHE BIORITËM”, TRIBUNA FETARE NË PRAG TË RAMAZANIT 1436/2015

Pasditën e së shtunës, më 13 qershor 2015, Myftinia Shkodër organizoi një tribunë shkencore në pritje të muajit Ramazan, ku i ftuar special si ligjërues, ishte shkencëtari i mirënjohur i trevave shqiptare, Dr. Ali F. Iljazi nga Gjakova.

“Ndikimi i agjërimit në proceset biokimike dhe bioritëm”, ishte tema e këtij takimi, ku mjeku i mirënjohur gjakovar, shqyrtoi shumë nga dobitë dhe mrekullitë e agjërimit të muajit Ramazan, në trupin dhe shëndetin e njeriut.

Aktiviteti nisi me leximin e një pjese kur’anore nga hafizi i nderuar nga Gjakova, hfz. Safet Hoxha, që e zbukuroi atmosferën me shpirtin e ajeteve të agjërimit.

Më pas, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, falënderoi të

pranishmit, që kishin mbushur oborrrin e xhamisë së Parrucës, për pjesëmarrjen në këtë tribunë vlerash, në prag të muajit Ramazan. Njëkohësisht shprehu kënaqësinë dhe vlerësimet e tij për të ftuarin special, si një personalitet i afirmuar në trevat shqiptare dhe përtej tyre, për aftësinë e madhe të paraqitjes së argumenteve shkencore në dobi të lehtësimit të kuptimit të argumenteve fetare, për besimtarët dhe jo vetëm.

Ndërkohë, teologu Arben Halluni, lexoi një jetëshkrim të shkurtër të ftuarit të nderuar, Dr. Ali Iljazi, duke njohur të pranishmit me arritjet e tij kryesore në jetën shkencore.

Me shumë kënaqësi dhe emocion, të pranishmit ndoqën shpjegimet e qarta, që Dr. Ali Iljazi dha në lidhje me vlerat e mëdha, që agjërimi i Ramazanit ka për shëndetin dhe jetën e njeriut. Ai përmendi argument të shumta, që lidhen

me faktin sesi mjekësia perëndimore ka ngritur klinika të posaçme për studimin dhe analizimin e vlerave të agjërimit njëmuji që bëjnë muslimanët.

Dr. Ali Iljazi iu referua mjekëve dhe shkencëtarëve të shquar perëndimorë, që kanë dhënë dëshmitë e tyre shkencore mbi vlerën dhe dobitë e mëdha që agjërimi i Ramazanit ka, sidomos në rehabilitimin e proceseve të shumta kimike, me të cilat përballat organizmi i njeriut përgjatë gjithë vitit.

Ligjërata e mbajtur nga Dr. Ali Iljazi ishte një vlerë e madhe, në prag të këtij muaji të begatë, që të gjithë e presim me shumë mall, si një stacion i rëndësishëm në jetën e secilit.

Në përfundim të aktivitetit, u shpërndanë kalendarët e Ramazanit të sivjetshëm, fletëpalosjet me shpjegimet e kushteve dhe rregullave të agjërimit etj.

Paraditën e së martës, më 16 qershor 2015, u zhvillua takimi i radhës i imamëve të Shkodrës, në prag të hyrjes së Muajit Ramazan 1436.

Me këtë rast, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, uroi imamët për këtë mirësi të madhe që po i vjen mbarë botës; muaji Ramazan.

Ai theksoi se detyra e imamëve dhe prijësve fetarë është një përgjegjësi e rëndë, sidomos gjatë Ramazanit, ku angazhimi shumëfishohet.

Myftiu kërkoi nga imamët të jenë bashkues dhe nxitës të harmonisë në komunitetet ku shërbejnë.

Në këtë takim u dhanë edhe udhëzimet e fundit për mbarëvajtjen e aktivitetit fetar në xhamitë e Shkodrës, falja e rregullt e 20 rekateve të lehta të teravisë, respektimi i orareve të imsakut dhe iftarit, këndimi në kohë i ezanit etj.

U lajmërua se duke nisur nga dita e parë e agjërimit dhe në vijim, deri

TAKIMI I IMAMËVE NË PRAG TË RAMAZANIT 1436



në Natën e Kadrit, do të nisë edhe leximi i plotë i Kur'anit Famëlartë në xhaminë e Parrucës, pas namazit të iqindisë, ditë pas dite, si një traditë tashmë e konsoliduar në qytetin e Shkodrës.

U shpërndanë edhe kalendarët, fletëpalosjet dhe posterat e Ramazanit, në mënyrë që kushdo që nuk është pajisur ende me kalendarin e Ramazanit, ta kërkojë pranë xhamisë së lagjes a fshatit të tij.

Paraditën e së martës, më 16 qershor 2015, Myftinia e Malësisë së Madhe organizoi një tribunë fetare me rastin e Muajit Ramazan, ku ligjërues ishte Imam Muhamed Sytari, Myfti i Zonës Shkodër.

Aktiviteti u hap me leximin e një pjese kur'anore nga imami Nadi Braqi.

Më pas, Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, uroi të pranishmit për prezencën e tyre dhe theksoi se ky organizim i paraprin aktiviteteve të muajit Ramazan, të cilin ia uroi të gjithë besimtarëve. Myftiu theksoi se agjërimi i Ramazanit është një adhurimi i shumëpritur për besimtarët muslimanë dhe një shkollë e madhe besimi dhe disipline në jetë.

I ftuar për të ligjëruar në këtë aktivitet, Imam Muhamed Sytari, hodhi dritë mbi rëndësinë që ka agjërimi në rritjen e cilësisë së adhurimit në jetën e besimtarëve.

Ai përmendi disa nga dobیتë shëndetësore të agjërimit, duke theksuar se ata që e praktikojnë agjërimin në vazhdimësinë, e ndiejnë më mirë se kushdo vlerën dhe madhësitinë e agjërimit, si dhe ndikimin e tij pozitiv në shëndetin e tyre.

Më pas, Myftiu foli mbi rëndësinë që ka dëshmimi i frymës së agjërimit në

MALËSIA E MADHE, TRIBUNË FETARE NË PRAG TË RAMAZANIT



shoqëri, duke u ndjerë shpirti i besimit kudo; në tregje, në dyqane, në rrugë, në veshje, në komunikim, në xhami, në familje etj.

“Dikur, na thonin se kur vinte Ramazani, edhe të krishterët ruheshin të mos hanin e të mos pinin në mënyrë demonstrative, në respekt të muslimanëve. Pra, kjo vërteton më së miri se shoqëria shqiptare ka ditur të respektojë besimin dhe ta vlerësojë atë. Sot, më shumë se kurrë kemi nevojë që

këto mësimet t'i përhapim në mesin tonë, që të respektohet Ramazani, të respektohen agjëruesit, të nderohet muaji i Kur'anit!”, - tha ndër të tjera Myftiu.

Ai solli argumente të ndryshme nga Kur'ani, Tradita profetike, jeta e të parëve dhe shembuj nga ditët tona, që vërtetojnë madhësitinë e agjërimit dhe vlerën e tij, si dhe kthimin e të parëve nga Kur'ani, sidomos në ditët dhe netët e këtij muaji vlerash dhe ripërtëritjeje.

Pasditen e së martës, më 16 qershor 2015, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me Shoqatën Humanitare Kulturore Shqiptare në Vjenë (Austri) - "Xhamia Imam El-Buhari", organizoi shpërndarjen falas të përkthimit të kuptimeve të Kur'anit Famëlartë në gjuhën shqipe, në italisht dhe anglisht.

Aktiviteti u zhvillua në pedonalen para Bashkisë Shkodër, ku kalimtarë të shumtë u ndalën për të marrë një kopje të "Kur'anit", si dhe kalendarin e agjërimit të Ramazanit. Të shumtë ishin qytetarët që nuk i mbanin lotët, teksa merrnin në dorë përkthimin e kuptimeve të Kur'anit, sipas versionit të H. Sherif Ahmetit dhe atë të H. Hasan Nahit.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari. Ai theksoi se në atmosferën e bukur të prag Ramazanit të sivjetshëm, ky aktivitet ka një domethënie të madhe, pasi Kur'ani nisi të zbresë në Ramazan. Myftiu theksoi se Kur'ani duhet lexuar nga të gjithë, në mënyrë që të kuptohet drejtë, sidomos në këto kohë.

SHPËRNDAHET PËRKTHIMI I KUPTIMEVE TË KUR'ANIT NË GJUHËN SHQIPE



"Dua të përmend se sponsor i këtij botimi është një shoqatë islame shqiptare në Vjenë të Austrisë. Kjo do të thotë se tashmë drita e Islamit po vjen edhe nga perëndimi. Dhe, sikurse e kam thënë edhe në takime të tjera, ky shekull është shekulli i Islamit dhe drita e tij po mbulon gjithësinë,

si një pelerinë e begatë, si një balsam shërues", - tha ndër të tjera Myftiu.

Myftinia Shkodër shpreh mirënjohjen dhe falënderimet e saj për Shoqatën "Xhamia Imam El-Buhari", në Vjenë dhe për të gjithë vullnetarët që iu bashkuan këtij aktiviteti të dobishëm komunitar.

Paraditën e së mërkures, më 17 qershor 2015, në prag të Muajit Ramazan, në një atmosferë të mrekullueshme besimi dhe qytetarie shkodrane, u inaugurua xhamia e re e lagjes Dudas.

Ceremonia e inaugurimit u përshëndet nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i cili falënderoi All-llahun për mirësinë e madhe të kësaj dite të gëzueshme, ku pas shumë dekadash, u mundësua ringritja e xhamisë së re në Dudas, një prej lagjeve muslimane më të vjetra në Shkodër.

Myftiu falënderoi kontributin e madh të Fondacionit "Mirësia", drejtorit të saj, z. Korab Kaja, si dhe donatorit nga Kuvajti, për këtë dhuratë të bukur, që u konkretizua sot, në prag të pritjes së Hënës së re të Muajit Ramazan.

Ndërkohë, drejtori i Fondacionit "Mirësia", z. Korab Kaja, vlerësoi këtë mirësi, si një mundësi e re që banorët e lagjes Dudas kanë për të kryer adhurimet e tyre në kushte të përshtatshme, si dhe fëmijët e tyre, për mësimin e besimit dhe Kur'anit, në ambientet komode që ofron kjo xhami e re.

Ai e vlerësoi këtë ditë si moment

DUDAS, U INAUGURUA XHAMIA E RE E LAGJES



gëzimi për krejt lagjen e vjetër muslimane të Dudasit dhe mbarë Shkodrën.

Në shoqërinë e tekbireve, u bë prerja e shiritit, që u pasua me faljen e namazit të parë të mesditës nga të pranishmit e shumtë, që kishin tejmbushur xhaminë.

Pas përfundimit të faljes së namazit dhe duasë së bërë nga Myftiu, të pranishmit u përfaquan me gëzim duke këmbyer gëzimin e madh për xhaminë e re dhe duke u përhapur me rastin e

Muajit Ramazan.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin edhe: H. Edmir Smajlaj (Myfti i Malësisë së Madhe), z. Gëzim Kopani (Myfti i Pukës), z. Kujtim Dervishi (drejtor i Medresesë "Haxhi Sheh Shamia"), z. Tahir Zeneli (kryetar i Shoqatës "Ardhmëria"), z. Justinian Topulli (kryetar i Lidhjes së Hoxhallarëve të Shqipërisë), z. Ridvan Seferaj (kryetar i Shoqatës "Istanbul"), z. Ramazan Avxhe (kryetar i Vakfët "Umraniye"), imamë të xhamive të Shkodrës e Malësisë së Madhe etj.

Pasditen e së xhumasë, më 19 qershor 2015, Myftinia Shkodër organizoi promovimin e botimit më të ri të imamit dhe teologut Lavdrim Hamja, me titull: “40 hadithe mbi agjërimin dhe Ramazanin”.

Aktiviteti u përshëndet nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i cili vlerësoi punën e palodhshme të thirrësit islam Lavdrim Hamja, sidomos në drejtim të përkthimit nga gjuha arabe të materialeve të dobishme për lexuesin dhe besimtarët.

Myftiu theksoi se, përgjegjësia e imamëve, sidomos në ditët e sotme, është shumë e madhe, prandaj duhet punuar pa pushim në drejtim të përhapjes së dritës dhe vlerave të Thirrjes Islame në vendin tonë.

Edhe Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, uroi të pranishmit me rastin e fillimit të muajit Ramazan, sikurse u ndal te vlerësimi i këtij botimi, si një dhuratë e bukur në këtë Ramazan. Myftiu i nderuar theksoi se imamët dhe teologët e rinj, kanë mundësi të shumta për të kontribuar në forcimin e mësimave të fesë dhe

“40 HADITHE MBI AGJËRIMIN DHE RAMAZANIN”, NË DUART E IMAMËVE



përhapjen e tyre në shumë drejtime. Njëkohësisht falënderoi autorin e këtij punimi për këtë kontribut të vyer.

Në fjalën e tij, teologu Lavdrim Hamja, vuri në dukje shtysat që e kanë nxitur të punojë për të nxjerrë këtë punim, që do t'i shërbejë lexuesve, sidomos në Ramazan, për të kuptuar më mirë vlerën dhe rëndësinë e

agjërimin dhe muajit Ramazan.

Ai falënderoi të pranishmit për vlerësimin e kësaj ftese dhe uroi që nga ky botim të ketë dobi.

Pas faljes së akshamit me xhemat, të pranishmit morën pjesë në iftarin e shtruar nga Myftinia Shkodër me këtë rast.

Ditën e enjte, më 18 qershor 2015, pas namazit të iqindisë, në xhaminë e Parrucës, Myftinia Shkodër nisi mexhlin e leximit të plotë të Kur'anit Famëlartë, shoqëruar me ndalesa të shumta, ku shpjegohen ajete të ndryshme, jepen të dhëna interesante, komente të larmishme etj.

Mexhlisi nisi me një hyrje, ku Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, hodhi dritë mbi dobitë e leximit të Kur'anit dhe vlerën e xhematit në këto tubime të paqta. Ai tha se kjo traditë e vjetër ka një vlerë të madhe shpirtërore, teksa na angazhon për të lexuar çdo ditë prej ditëve të Ramazanit, nga një xhyz a më shumë nga Kur'ani Famëlartë, mësimi i tij, shpjegimi i ajeteve të ndryshme dhe përfitimi nga përshpirtësia që fitohet në këto tubime.

Myftiu bëri një homazh edhe për hoxhallarët e shkuar të Shkodrës, mësuesit e Kur'anit dhe të gjithë ata besimtarë, që i mungojnë këtij mexhli, nga viti i kaluar.

MEXHLISI I HATMES SHERIFE NË XHAMINË E PARRUCËS...



Më pas, nisi leximi i xhyzit të parë, shoqëruar me disa ndalesa, ku u hodh dritë mbi komente interesante të ajeteve të para të sures “El-Bekare”.

Në këtë mexhli, merrnin pjesë edhe imamët Naim Naim Drijaj, Lavdrim Hamja dhe Nadi Braqi, që iu bashkuan këtij tubim të begatë duke

ndarë së bashku kënaqësinë e leximit në këtë ditë të parë.

Me mbarësinë e All-llahut, Mexhlisi i Hatmes Sherife, do të vazhdojë çdo ditë prej ditë e të Ramazanit, pas namazit të iqindisë, deri në ditën e 26-të, ku do të bëhet edhe dua e hatmes, që i parapron Natës së Kadrit.

MYFTINIA SHKODËR JU URON: ME ZEMËR TË MIRË RAMAZANIN!



Xhamia e re e lagjes Dudas

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja
Dizajn & Grafik:
Bledar Xama

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org